



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.873/14 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

V E N D I M

Nr.276, datë 26.11.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.136 Regj., datë 03.06.2025, paraqitur nga z. H.M dhe z. A.M, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Gostim-Cërrik, linjë e cila operohet nga shoqëria “Gxxxxx travel” sh.p.k., me NIPT xxxxxxxxxx.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesit, në parashtrimet e depozituara pranë Komisionerit, ndër të tjera, citojnë se: “Unë i nënshkruari H.M së bashku me shoqëruesen time dhe një anëtar të Shoqatës Shpresë për të verbërit shokun A.M, në datën 28.05.2025, do të udhëtonim nga Cërriku për në Gostim dhe hipëm në furgonin me targ AA 346 MK rreth orës 08:00 dhe kemi arritur rreth orës 08:30. Kur zbritëm dhe paraqitëm librezën, nuk na u njoh librezja dhe na kërkuan të paguanim biletë të plotë, duke na thënë që nuk e njohim fare si librezë.”

Përfundimisht ankuesit kërkojnë nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave që vijnë për shkak të tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 32 e 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Fillimisht, në kushtet kur pala ankuese nuk kishte identifikuar subjektin, i cili pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese, por vendosi në dispozicion të Komisionerit vetëm disa informacione në lidhje me linjën e transportit të përdorur dhe targën e mjetit, Komisioneri me shkresën nr.873/1 prot, datë 09.06.2025, ju drejtuar me një kërkesë për informacion Bashkisë Cërrik, me qëllim administrimin e të dhënave që do të mundësonin identifikimin e subjektit. Bashkia Cërrik nuk ktheu përgjigje. Me shkresën nr.873/2 prot, datë 16.07.2025, Komisioneri iu drejtuar sërisht Bashkisë Cërrik me të njëjtën kërkesë.
2. Me shkresën nr.873/3 prot datë 22.07.2025, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion, me qëllim administrimin e të dhënave që do të mundësonin identifikimin e subjektit, edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). DPSHTRR, ktheu përgjigje me shkresën nr.14898/1 prot, datë 29.07.2025, duke informuar ndër të tjera se: “...Linjat e transportit të udhëtarëve Cërrik-Gostimë-Cërrik dhe anasjelltas nuk janë pjesë e rrjetit të linjave të transportit ndërqytetës të udhëtarëve me autobus, por janë linja të transportit rrethqytetës për të cilat organi kompetent i licencimit dhe certifikimit është Bashkia e Elbasanit.” Nëpërmjet shkresës sipërcituar, DPSHTRR informon se, nga verifikimi në sistemin elektronik *edpshtrr*, rezultoi se mjeti me targa AA 346 MK, është në pronësi të subjektit Gxxx travel, me NIPT xxxxxxxx.
3. Në vijim të informacionit të administruar nga DPSHTRR, me shkresën nr. 873/5 prot datë 06.08.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga Shoqëria Gxxx travel sh.p.k, Bashkia Elbasan dhe Task-Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Mototrike e Rimorkiove të Tyre.
4. Në vijim të kësaj kërkesë, me shkresën nr.1208/1 prot datë 15.08.2025, ka kthyer përgjigje Task-Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Mototrike e Rimorkiove të Tyre, duke informuar ndër të tjera se, gjatë periudhës 1.01.2023 – 13.08.2025, krahas linjave të tjera kombëtare është monitoruar edhe linja Cërrik-Gostimë-Cërrik, ku nga kontrolli i mjeteve të transportit të udhëtarëve janë konstatuar në shkelje subjektet “Gxxx travel” sh.p.k dhe “Gxxxxx”. Nga informacioni i raportuar nga Task-Forca, rezultoi se sheljet e konstatuara nuk kanë të bëjnë me mosrespektimin e detyrimeve të pasagjerëve me aftësi të kufizuara. Task-Forca bën me dije se nga takimi që ka zhvilluar me Administratorin e shoqërisë Gxxx travel sh.p.k, z. Th. I, ky i fundit është shprehur se do të marrë të gjitha masat për të respektuar

legjislacionin në fuqi për transportin rrugor të udhëtarëve, përfshi këtu edhe kategorinë e udhëtarëve të cilët janë të pajisur me librezë nga Shërbimi Social Shtetëror”.

5. Me shkresën nr. 1609/1 prot, datë 31.07.2025, Bashkia Cërrik, informoi Komisionerin, ndër të tjera se: “...sapo u njohëm me rastin e cituar për diskriminim, verifikuam sipas pretendimeve të dy pasagjerëve z. H.M dhe z.A.M, me të drejtë kanë ankimuar shqetësimin e tyre për mos aplikim të gjysmës së biletës edhe pse i kanë treguar librezën si invalid, por fatorino nuk ka marrë për bazë pasi edhe pas diskutimit që patëm me Administratorin e shoqërisë Gxxxx Travel sh.p.k z. Th.I, pohon se nuk e mban mend si rast për denoncuesit, nuk më ka nxjerrë dikush librezë invaliditeti, por pohon se nuk rimburosohet nga instancat përkatëse për këtë grup shoqëror për personat me aftësi të kufizuara. Pasi verifikuam dosjen e tij, shoqëria operon konform rregullave për linjën rrethqytetase, konform ligjit të fituar me konkurs sipas procedurave të kryera nga Bashkia Cërrik. Të dhënat e shoqërisë:
- Licenca nr.3 datë 02.04.2018 me datë mbarimi 18.04.2028, intenerari i linjës Cërrik-Shtërmën, Gostimë, Shtëpanj, Shushic.
 - Certifikata me nr.3, datë fillimi 29.10.2024 dhe datë mbarimi 29.10.2025, e verifikuar për targën AA 346 MK, rezulton konform legjislacionit në fuqi.

Bashkia Cërrik ka marrë masa dhe ka rënë dakort, jemi në fazën finale që biletat ti rimbursojë. Jemi duke punuar me Drejtorinë e Financave pranë Bashkisë Cërrik për përmbyllje të projekt vendimit konform legjislacionit, buxhetit të mundur, informacionin e numrit të grupit të parë invalid edhe ndarjen e 5 linjave që operojnë në territorin tonë, kemi mbyllur marrëveshjen me një linjë urbane të linjës së rregullt Cërrik-Elbasan edhe anasjelltas.”

6. Me shkresën nr.1873/1 prot, datë 25.08.2025, Bashkia Cërrik, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “.... Ashtu siç kemi pasqyruar edhe në shkresën e parë mbi ankesat e z. H.M dhe z.A.M, me të drejtë kanë paraqitur shqetësimin e tyre lidhur me mosaplikimin e gjysmës së biletës apo edhe rimbursimin e plotë të saj, ndonëse janë pajisur me dokumentacionin përkatës të statusit të invalidit. Administratori i firmës Gxxx Travel sh.p.k është thirrur dhe ka dhënë deklaratën me shkrim se nuk do të ndodh me një incident të tillë, si dhe të gjitha mjetet janë të pajisur me tabelën përkatëse ku citohet se nuk do të kërkohet pagesë nga grupi i invalidëve. Bashkia Cërrik, ju informon se ka përfunduar të gjitha fazat e bisedimeve me shoqëritë përkatëse dhe më datë 30.07.2025 është miratuar nga Këshilli Bashkiak Cërrik rimbursim në linjat urbane, sipas numrit të invalidëve të grupit të parë, me specifikimet përkatëse të gjatësisë së linjës në km, si dhe numri i linjave që mbuohen. Konfirmimi i prefekturës me shkresën nr.890/1 datë 15.08.2025..”
7. Me shkresën nr.873/9 prot, datë 09.09.2025, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë të përsëritur për informacion Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë Gxxx travel sh.p.k, të cilët nuk kishin kthyer asnjë përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar.
8. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 873/10 prot., datë 15.09.2025, Shoqëria Gxxx travel sh.p.k ka kthyer përgjigje, duke parashtuar ndër të tjera se: “.....Në datën e

pretenduar nga ana e ankuesve, ka patur një incident të tillë në linjën e transportit të udhëtarëve Cërrik-Gostime. Shoferi B. L, me të cilin ka ndodhur incidenti, ka filluar punë më datë 01.04.2025, pra ishte shofer i ri me kontratë në periudhë prove. Nga ana tjetër nuk ka patur dijeni për detyrimin për transport të personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër shoqëria Gxxx Travel shoqëri transporti e udhëtarëve të linjës Cërrik-Gostimë e kthim, nuk ka patur kontakte me Bashkinë Elbasan për shërbimin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo shoqëri ka marrë licencën nr.3 datë 03.04.2018 deri më 02.04.2028 pranë Bashkisë Cërrik. Edhe me Bashkinë Cërrik, për transportin e personave me aftësi të kufizuara është lidhur akt marrëveshje në datën 10.09.2025 në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.49, datë 30.07.2025. Pra kjo kompani nuk ka patur marrëveshje për transportin e personave të tillë, megjithatë ne pranojmë përgjegjësinë tonë për një zgjidhje humanitare të incidentit të ndodhur. Duke marrë shkas nga ky incident, kompania mori masat dhe në mjetet tona të transportit të udhëtarëve ka vendosur lajmërimin që transporti i personave me aftësi të kufizuara të bëhet pa pagesë. Në lidhje me vonesën në dërgimin e përgjigjes tonë, ju kërkojmë ndjesë, pasi nga ana e Administratorit z. Th.li janë bërë përçapjet duke shkuar dhe sqaruar çështjen në rrugë verbale. Edhe nga Bashkia Cërrik administratorit i është komunikuar fakti se do të sqarojnë zyrtarisht këtë problem me Drejtorinë e Hetimit Administrativ pranë Komisionerit. Sqarojmë gjithashtu se kjo kompani ushtron aktivitetin në juridiksionin e Bashkisë Cërrik dhe jo Bashkisë Elbasan.”

9. Me shkresën nr. 3978/2 prot, datë 22.09.205, Bashkia Elbasan informon se, linja Elbasan-Gostimë është linjë rrethqytetëse dhe ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Cërrik dhe licenca për transportin rrethqytetës jepet nga Kryetari i Bashkisë ku ka selinë subjekti transportues.
10. Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.” dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, me shkresën nr.873/11 prot., datë 16.09.2025 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 24.09.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palës ankuese, ndërsa pala ndaj së cilës është paraqitur ankesa nuk mori pjesë, megjithëse nga njoftimi postar rezultoi se kishte marrë dijeni për zhvillimin e saj.

Gjatë seancës iu nënshtuan diskutimit veprimet e ndërmarra nga Bashkia Cërrik në lidhje me trajtimin e rastit konkret por edhe dhe adresimin e kësaj problematike në raport me të gjithë personat me aftësi të kufizuara, si dhe si dhe qëndrimin dhe masat e marra nga ana shoqërisë “Gxxx travel” sh.p.k.

Pala ankuese deklaroi gjatë seancës se, pas zbatimit të marrëveshjes, ka udhëtuar sërish në linjën Gostimë–Cërrik me mjetet e shoqërisë “Gxx travel” sh.p.k dhe nuk i është kërkuar pagesë për biletën.

- *Vlerësimi i Komisionerit.*

Bazuar në aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesit H.M dhe A.M, janë persona me aftësi të kufizuara në shikim, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të librezave të verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Ankuesit, kanë udhëtuar në datën 28.05.2025 nga Cërriku për në Gostim në mjetin me targa AA 346 MK rreth orës 08:00, mjet i cili i përket shoqërisë së transportit “Gxx travel” sh.p.k, e cila operon në linjën e transportit të udhëtarëve Cërrik-Gostimë-Cërrik, linjë kjo e transportit rrethqytetas, sipas licencës nr.3, datë 02.04.2018, lëshuar nga Bashkia Cërrik.

Kur ankuesit kanë zbritur në destinacionin e tyre, nga shoferi i mjetit iu është kërkuar që të paguanin biletën e udhëtimit.

Ankuesit kanë paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, shoqëria “Gxxx travel” sh.p.k pranoi se shoferi i cili kishte qenë në drejtimin e mjetit me të cilin kishin udhëtuar ankuesit, iu kishte kërkuar pagësën e biletës, por kjo sipas shoqërisë nuk ishte një praktikë e saj, por kishte ndodhur për shkak se shoferi ishte një punonjës i ri dhe nuk kishte patur dijeni për detyrimet ligjore për transportin e personave me aftësi të kufizuara. Shoqëria “Gxxxx travel” parashtroi se, në kohën që ka ndodhur ngjarja shoqëria nuk ka patur një aktmarrëveshje të lidhur me Bashkinë Cërrik megjithatë menjëherë pas rastit, shoqëria mori masa duke vendosur në mjetet e saj të transportit të udhëtarëve lajmërimin se transporti i personave me aftësi të kufizuara të bëhet pa pagesë. Shoqëria “Gxxxx travel” sh.p.k, deklaroi se është plotësisht e angazhuar që situata të tilla të mos përsëriten më gjatë ofrimit të shërbimit nga ana e saj.

Nga aktet e administruara rezulton se, midis Bashkisë Cërrik dhe Shoqërisë “Gxxx travel” sh.p.k, është lidhur akt-marrëveshja nr.2030 prot., datë 10.09.2025, e cila ka si objekt të saj kompesimin e operatorit të shërbimit të transportit të udhëtarëve në linjat rrethqytetëse nga ana e Bashkisë Cërrik, për transportin rrethqytetës të personave me aftësi të kufizuara të grupit të parë (me shoqërues), në linjat përkatëse të transportit, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 30.07.2025. Kjo marrëveshje parashikon që operatorët e transportit të ofrojnë shërbimin falas për këtë kategori qytetarësh, ndërsa Bashkia merr përsipër kompensimin financiar të kostove përkatëse, në bazë të listave mujore dhe dokumentacionit të dërguar nga operatorët.

Menjëherë pas njoftimit të ankesës, rezulton se Bashkia Cërrik ka reaguar duke vendosur kontakte me shoqërinë e transportit për të verifikuar pretendimet e paraqitura nga ana e ankuesve dhe në vijim është përfunduar akt-marëveshja e datës 10.09.2025, e cila parashikon që operatorët e transportit të ofrojnë shërbimin falas për këtë kategori qytetarësh, ndërsa Bashkia merr përsipër kompensimin financiar të kostove përkatëse, në bazë të listave mujore dhe dokumentacionit të dërguar nga operatorët.

Pala ankuese deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, ka udhëtuar sërish në linjën Gostimë–Cërrik me mjetet e shoqërisë “Gxxx travel” sh.p.k dhe nuk i është kërkuar pagesë për biletën.

Nga shqyrtimi i plotë i çështjes rezulton se pas nënshkrimit të akt-marrëveshjes me operatorët e transportit, situata është përmirësuar ndjeshëm dhe janë marrë masa efektive për të garantuar pa diskriminim shërbimet e transportit publik ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, kërkitimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet parashikimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin në linjat urbane rrethqytetase të personave me aftësi të kufizuara.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa, në nenin 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi nëpërmjet masave të marra është zgjidhur problematika e adresuar pranë Komisionerit. Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e Bashkisë Cërrik, përmes parashikimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin e personave me aftësi të kufizuara, në linjat urbane rrethqytetase;
- Sjelljen e shoqërisë Gxx travel sh.p.k dhe angazhimin e saj për të mos lejuar përsëritjen në të ardhmen të situatave të të njëjtës natyrë;
- Faktin që ndaj Shoqërisë Gxxxx travel sh.p.k nuk janë paraqitur ankesa të tjera të të njëjtës natyrë, pra është subjekt për herë të parë;
- Qëllimin parandalues të Komisionerit dhe jo vetëm konstatues dhe ndëshkues;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr.136 Regj., datë 03.06.2025, paraqitur nga z. H.M dhe z. A.M, kundër shoqërisë “Gxxx travel” sh.p.k., duhet të deklarohej e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.137 Regj., datë 03.06.2025, paraqitur nga z. H.M dhe z. A.M, pa një vendim përfundimtar, për sa kohë që është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime/Transport
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti